



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2023
Nr. Dok. 202300344/2

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e bërë në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë në Berat.*

Drejtuar : Drejtues i parë Kastriot SKËNDERI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

BERAT

Komisar Altin MENE
Shef i Komisarariatit të Policisë Berat

BERAT

Për dijëni: Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në vendet ku privohet liria e personit gjegjësisht në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë në Berat.

Inspektimi u krye në datën 06.04.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu znj.Nertila Qafzezi dhe z. Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019, për miratimin e

procedurës standarde të punës “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në inspektimin e datës 03.11.2022¹, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara në vijim:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, mjedise ku mbahen e trajtohen shtetasit që iu është privuar liria, grupi i inspektimit u takua fillimisht me Drejtorin e Drejtorisë Vendore z. Kastriot Skënderi e më pas me shefin e Komisarariatit z. Altin Mene të cilët u vunë në dijeni në lidhje me qëllimin e inspektimit.

Drejtuesit e policisë, informuan grupin e inspektimit mbi gjendjen e kushteve në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, masat e marra për përmirësimin e kushteve në këto ambiente, garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e këtij komisaritati, si dhe plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Mekanizmi Kombëtar në inspektimin periodik të zhvilluar më datë 03.11.2022.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, verifikoi kushtet në të cilën ndodhen dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Berat, u njoh dhe administroi dokumentacionin që kishte të bënte me pasqyrimin e veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, që në momentin e hyrjes të personave të shoqëruar në mjediset e këtij komisaritati.

Drejtuesit dhe punonjësit e Komisarariatit të Policisë Berat, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që zhvilloi grupi i monitorimit në ambientet e këtij institucioni.

Nga informacioni dhe verifikimi në vend i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 03.11.2022² rezultoi se:

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë brenda territorit të Komisarariatit të Policisë Berat, në përputhje me normat dhe parametrat teknikë të parashikuara në legjislacionin në fuqi, si dhe as rekomandimi**

¹Shkresa nr.K4/I80-2 prot., datë 12.12.2022 “Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë në Berat”.

² Shkresa nr. 3588/1 prot., datë 22.12.2022 “Dërgohet informacion për shkresën K4/I80-2 prot., datë 12.12.2022” nga Komisaritati i Policisë Berat.

Shkresa nr. 9628/1 prot., datë 27.12.2022 “Mbi zbatimin e rekomandimeve, në lidhje me inspektimin e bërë në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP/Komisariatit të Policisë Berat” nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

për mbylljen e dhomave të sigurisë që ndodhen në ambientet e IEVP-së dhe Spitalin Rajonal Berat.

2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për krijimin e një ambienti të ri shoqërimi, me dhoma të ndara më vete për qëndrimin e personave të rritur, femra dhe të mitur, me kushte dinjitoze dhe të pajisura me orenditë e nevojshme.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit ekzistuese, për eliminimin e lagështirës në këto ambiente, deri në krijimin e një ambienti të ri shoqërimi.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi** për instalimin e sistemit të kamerave në ambientin e shoqërimit, me qëllim mbajtjen në vëzhgim të punonjësve të policisë gjatë veprimeve që kryejnë me të shoqëruarit.
5. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për krijimin e dhomës për intervistimin/marrjen në pyetje të të shoqëruarve në moshë madhore, para se të dërgohen në dhomat e sigurisë, me qëllim parandalimin e veprave të dhunshme ndaj shtetasve që mbahen dhe trajtohen në mjediset e policisë.
6. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në ambientet e komisariatit.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

1. **Ishte plotësuar në parim rekomandimi** për verifikimin e përputhshmërisë së projektit me procedurat standarde të miratuara me Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Urdhrin nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”* dhe Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde të punës për *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, për të garantuar si elementët e sigurisë por edhe kushtet dinjitoze për të ndaluarit/shoqëruarit apo edhe punonjësit e policisë, pasi ishte ngritur grup pune me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për hartimin e projektit dhe kryerjen e punimeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimit, të sigurisë dhe ambienteve ndihmëse të tyre të kryhen sipas kritereve të përcaktuar në urdhrat e mësipërm.

Avokati i Popullit është koshentë se ka kaluar një kohë e shkurtër nga inspektimi pararendës dhe se disa nga rekomandimet nuk mund të zbatohen tërësisht, ndonëse të pranuar.

Në përgjigje të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit³ na ka informuar se, i pranon rekomandimet e Avokatit të Popullit si të drejta dhe se nisur nga gjendja aktuale e objekteve ku ushtron

³ DPPSH me shkresë nr.9628/1 prot., datë 27.12.2022 drejtuar Avokatit të Popullit.

aktivitetin Drejtoria dhe Komisarjati i Policisë Berat, nga DPPSH është përgatitur projekti i Zbatimit për “Rikonstruksionin/Ndërtimin e objekteve të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat”. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit sqaron se, *“Projekti për Rikonstruksionin/ Ndërtimin e objekteve të Drejtorisë Vendore dhe Komisarjatin e Policisë Berat, me vlerë 260,291,823 lekë (me TVSH) është i gatshëm dhe për zbatim. Sipas PBA 2022-2024, implementimi i këtij rojekti është parashikuar të fillojë gjatë vitit 2023”*.⁴

Nga inspektimi dhe nga informacioni i drejtuesve të policisë Berat u evidentua se ishin miratuar fonde në buxhetin e DPPSH për zbatimin i këtij projekti, si dhe na u bë me dije shkresa me nr. 12851/22 prot., datë 08.02.2023 e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me lëndë *“Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2023-2025, për shpenzimet kapitale”*, i cili ndër të tjera kishte parashikuar edhe rikonstruksionin e D.V.P. Berat, dhe nëpërmjet kësaj shkrese kërkohej marrja e masave urgjente për fillimin e procedurave të prokurimit të fondeve të miratuara si dhe shlyerja e detyrimeve ligjore të krijuara për të cilat janë çelur këto fonde.

Vlen të theksohet se nga inspektimi dhe nga informacioni i drejtuesve të policisë Berat u evidentua se, zbatimi i këtij projekti nuk kishte filluar ende, duke lënë të kuptohet se gjendja e dhomave të sigurisë dhe dhomave të shoqërimit në Komisarjatin e Policisë Berat, **ishte përkeqësuar në krahasim me vitin e kaluar**. Nga komunikimi me punonjësit e institucionit na u bë me dije se duke qenë se është miratuar fondi në buxhetin e DPPSH-së për vitin 2023, pritej fillimi i procedurave për zbatimin e projektit, fakt ky që kishte sjellë për pasojë edhe përkeqësimin dhe lënien pas dore të mirëmbajtjes së këtyre dhomave.

Grupi i inspektimit, i kushtoi rëndësi të veçantë plotësimit të kushteve të jetesës, pavarësisht gjendjes në të cilën ndodheshin dhomat e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë në Komisarjatin e Policisë Berat, sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde të miratuara nga DPPSH për ndërtimin e tyre, si dhe trajtimin e shtetasve në këto mjedise, në bazë të akteve ligjore dhe akteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e tyre.

Ambienti i shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisarjatin e Policisë Berat, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin nr.938 datë

⁴ Shkresa nr. 9628/1 prot., datë 27.12.2022 *“Mbi zbatimin e rekomandimeve, në lidhje me inspektimin e bërë në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në DVP/Komisariatin e Policisë Berat”* nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit⁵, për mbajtjen dhe qëndrimin e personave të shoqëruar në mjediset e policisë.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në godinë më vete, brenda teritorit të Drejtorisë/Komisariatit të Policisë Berat. Ambienti i shoqërimit përbëhej nga zyra e punonjësit të informacionit dhe nga 2 (dy) dhoma shoqërimi. Një nga dhomat e shoqërimit ishte për shoqërimin e personave të rritur, ndërsa dhoma tjetër shërbente për shoqërimin e grave.

Të miturit, mbaheshin dhe intervistoheshin në një mjedis të ri të krijuar brenda ambienteve në katin e parë të godinës të komisariatit, ndërtuar me mbështetje nga UNICEF dhe Qeveria Norvegjeze në kuadrin e Programit “Qasja e Fëmijëve në Drejtësi” 2019-2020.

Ambienti i intervistimit ishte i dedikuar për të miturit në konflikt me ligjin dhe njëkohësisht për viktimat e dhunës në familje. Ai përbëhej nga 3 dhoma si, dhoma për marrjen në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore e kompletuar me të gjitha pajisjet e regjistrimit të sistemit audio-viziv, dhoma e punës të punonjësve të policisë që ishin të trajnuar për këtë qëllim, si dhe dhoma e qëndrimit të të miturve, familjarëve, avokati mbrojtës dhe psikologu.

Psikologu ishte në organikë të DVP Berat, ndërsa avokati mbrojtës sigurohej nga dhoma e avokatisë Berat, të cilët ishin të pranishëm në të gjitha seancat e marrjes të të miturve në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore. Ambienti ishte i lyer dhe i pastër nga ana higjieno-sanitare.

Dhomat e shoqërimit kishin përmasa 2x3m dhe tjetra 3x3m dhe ishin të pajisura me tavolinë dhe me karrige, këmbët e të cilave ishin të fiksuar në dysheme. Kapaciteti fizik i dhomave të shoqërimit ishte për mbajtjen dhe qëndrimin e 4 personave. Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që lejonin ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral, të mbrojtura me skarë hekuri në pjesën e jashtme të tyre. Dhomat e shoqërimit kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Në ambientin e shoqërimit dhe në vende të aksesueshme ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar. Dyert e dhomave të shoqërimit ishin me bravë të rregullt dhe mbylleshin nga jashtë me çelës.

⁵ *Kreu VII, pika 4 gërmat b,c,e “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

Muret e dhomave të shoqërimit ishin të palyera dhe për shkak të lagështisë në disa vende kishte rënë suvaja dhe kishin nevojë për mirëmbajtje. Dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte tualete, por ato ndodheshin në ambientet e brendshme të godinës së komisariatit.

U evidentua se, mjedisi i shoqërimit nuk kishte sistem monitorimi me kamera⁶ për mbajtjen në vëzhgim të dhomave të shoqërimit. Kamerat e komisariatit, mbanin nën vëzhgim vetëm ambientet e jashtme të godinave të komisariatit.

Sipas drejtuesve të komisariatit, në mungesë të një ambienti më vete, marrja në pyetje e personave të shoqëruar, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit, të cilat nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave për të vëzhguar veprimet që kryejnë punonjësit e policisë gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar.

Mungesa e një sistemi të plotë të kamerave dhe e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme, gjatë kohës të qëndrimit në mjediset e policisë, si dhe nuk garantojnë të drejtat që ligji ju njeh këtyre personave.

Në momentin e inspektimit, grupi i monitorimit nuk gjeti asnjë shtetas të shoqëruar në këto ambiente. Nisur nga statistikat e hedhura në regjistër për periudhën Janar - Nëntor 2023 ishin regjistruar 106 persona të shoqëruar në mjediset e policisë të këtij komisariati.

Nga kqyrja e regjistrimit dhe dokumentacionit në zyrën e informacionit, u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga verifikimi i fashikujve që mbaheshin për personat e shoqëruar në zyrën e informacionit, u evidentua se, në përfundim të procedurave të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë në Komisaratin e Policisë Berat mbahej procesverbali i shoqërimit, i cili pasi firmosej, një kopje ruhej në arshivën e institucionit dhe një kopje i jepej personit të shoqëruar.

⁶ *Kreu VII “Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar” pika 5, gërma ç, “Rregullat e sigurisë gjatë kryerjes së veprimeve me personat e shoqëruar” e procedures standard të punës: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit*

Gjatë inspektimit, grupi i monitorimit nuk konstatoi në ambientin e shoqërimit, sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre.

Ambienti i sigurisë në Komisarlatin e Policisë Berat, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurën standarde të miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për *“Trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Ky ambient paraqiste probleme të qenësishme, të cilat bëhen më problematike, përse ky institucion kishte dhoma sigurie e mbliidhte të arrestuar/ndaluar nga komisarlatet e tjerë të Qarkut Berat. Zgjidhja e dhënë me miratimin e DPPSH-së, për vendosjen e dhomave të sigurisë jashtë territorit të Komisarlatit të Policisë në Berat, është në kundërshtim me normat dhe parametrat e ndërtimit dhe funksionimit të tyre, sikurse parashikohet në Kreu VIII, neni 1 deri neni 9 të procedurës standarde *“Trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Ambienti i sigurisë nuk ndodhej brenda territorit të Drejtorisë/Komisariatit, në kundërshtim me normat, parametrat dhe standardet e vendeve të BE-së, përcaktimeve të bëra në Konventën e “Për parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore e degraduese”, si dhe përcaktimeve të bëra në këtë procedurën standarde të lartpërmendur.

Sikurse u konstatua nga grupi i inspektimit, ambienti i sigurisë nuk kishte ndryshuar nga inspektimet e zhvilluara gjatë viteve të kaluara. Në mungesë të një blloku sigurie, ai ishte i ndarë në dy ambiente më vete, një ambient që ndodhej në IEVP-në Berat, ku mbahen e sigurohen të ndaluarit/arrestuarit në moshë të rritur dhe të miturit, si dhe një ambient ndodhej në Spitalin Rajonal Berat, ku qëndrojnë të ndaluarit/arrestuarit femra dhe të ndaluar/arrestuar të sëmurë të shtruar në regjim spitalor sipas rekomandimit të mjekut.

IEVP Berat, në bazë të një marrëveshjeje midis DPB-së dhe DPP-së, ka vendosur në dispozicion të Komisarlatit të Policisë Berat, dy dhoma sigurie që shërbenin për trajtimin dhe sigurimin e personave të ndaluar/arrestuar të rritur dhe të mitur.

Gjithashtu, në ambientet e Spitalit Rajonal Berat, ndodhej një dhomë e cila shërbente për shtrimin e personave të ndaluar/arrestuar që paraqesin probleme shëndetësore gjatë

kohës të qëndrimit në ambientin e sigurisë, e cila njëkohësisht shërbente dhe për akomodimin e personave të ndaluar/arrestuar femra.

Përsa më sipër, referuar dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se, punonjësit e policisë së shtetit bëjnë arrestimin/ndalimin e personit, duke i trajtuar këta persona në ambientet e posaçme të sigurisë të ngritura pranë komisariateve për këtë qëllim.

Ndërkohë, ligji nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ka për objekt përcaktimin e të drejtave dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, në bazë të vendimeve të dhëna nga gjykatat shqiptare, por dhe nga gjykatat e huaja në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, dhe nuk ka për objekt garantimin e të drejtave të personave të ndaluar/arrestuar me masë sigurie “arrest me burg”, pa një vendim gjykate.

Vendodhja e dhomave të sigurisë jashtë territorit të Komisarariatit të Policisë Berat, bie ndesh gjithashtu dhe me rekomandimet e Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018⁷. Në rekomandimin 1 të Raportit të CPT-së të përgatitur për këtë qëllim, theksohet se: “*Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje për t'i dhënë fund praktikës së mbajtjes në polici të personave me masë sigurie "arrest me burg" dhe të dënuarve me burgim me vendim të formës së prerë*”. Në analogji të këtij rekomandimi edhe IEVP-të nuk mund të mbajnë persona me masë sigurie “arrest me burg”, pa një vendim gjykate për vlefësimin e masës të sigurisë për shtetasit e ndaluar/arrestuar, brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Në zbatim të këtij rekomandimi, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit në vitin 2019 midis institucionit të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë të Shtetit⁸, ku parashikohet se, IEVP-të **nuk** do të administrojnë/akomodojnë persona të ndaluar për të cilët nuk ka një masë sigurie “arrest me burg”, me vendim nga organet e gjykatës.

Nisur nga argumentet ligjorë të lartpërmendur, vlen të theksojmë se, të drejtat që gëzojnë personat e ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë, në raport me personat e paraburgosur apo të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, janë të ndryshme (sikurse parashikohen shprehimisht në legjislacionin e përmendur më sipër), ndaj të drejtat e këtyre personave nuk mund të atakohen duke qëndruar në ambientet e

⁷ shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).

⁸ Neni 4 i Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.897/3 prot., datë 04.03.2019 për DPPSH dhe nr.2194 prot., datë 05.03.2019 për DPB.

regjimit të I EVP-së, për sa kohë nuk ka një vendim të organit të gjykatës për vleftësimin e masës të sigurisë për këta persona.

Në këto kushte, Institucioni i Avokatit të Popullit rithekson edhe njëherë, domosdoshmërinë e ndërtimit sa më parë të bllokut me dhomat e sigurisë brenda territorit të Komisarariatit të Policisë Berat, me kushte e standarde që mundësojnë garantimin e lirive dhe të drejtave ligjore të ndaluarve/arrestuarve, pasi në gjendjen që ndodhet, është në shkelje të kërkesave dhe parashikimeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit, nxit dhe mbështet institucionet qendrore vendimarrëse për planifikimin e buxheteve dhe zbatimin sa më parë të çdo projekti, që lidhet me investime kapitale, të cilat përmirësojnë kushtet e jetesës dhe trajtimin dinjitoz të personave, që ju privohet liria në mjediset e policisë së shtetit.

Pavarësisht vendodhjes së dhomave të sigurisë, grupi i inspektimit konstatoi se, në I EVP Berat ndodheshin 2 dhoma sigurie. Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për mbajtjen dhe akomodimin e 8 (tetë) personave të ndaluar/arrestuar. Dhoma e sigurisë për personat e rritur ishte me përmasa 4x5 m², e kompletuar me 3 krevate marine dhe me kapacitet për 6 (gjashtë) persona. Dhoma e sigurisë për të mitur ishte e pajisur me dy krevatë, me përmasa 3x4 m² dhe me kapacitet për 2 (dy) persona.

Nisur nga përmasat e dhomave të sigurisë, hapësira dhe sipërfaqe e tyre, rezulton se dhomat nuk ishin sipas kriterëve dhe parametrave për ndërtimin e dhomave të sigurisë të përcaktuara në procedurat standarde⁹ ku thuhet shprehimisht se, *“Normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë së dhomave për një të arrestuar/ndaluar janë: sipërfaqe të përgjithshme jo më pak se 10 metër katror, e cila ndahet në ambient qëndrimi (dhoma) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m²”*.

Dhoma e sigurisë që ndodhej në Spitalin Rajonal Berat, shërbente për mbajtjen dhe akomodimin e të ndaluar/arrestuar femra. Ajo ishte me hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme për jetesë normale me përmasa 4x4 m² dhe kishte kapacitet për 1 (një) person.

Këto dhoma sigurie, shërbenin njëkohësisht dhe për trajtimin dhe sigurimin e personave të ndaluar/arrestuar edhe nga Komisariami i Policisë Kuçovë dhe Skrapar. Ky fakt e bën dhe më urgjente situatën e dhomave të sigurisë në këtë drejtori.

Për periudhën Janar - Prill 2023, sipas regjistrit për evidentimin e të dhënave për personat e ndaluar/arrestuar, në dhomat e sigurisë ishin akomoduar 48 persona nga

⁹ *Kreu VIII, pika 8 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

komisariatet e policisë Berat, Skrapar dhe Kuçovë në varësi të DVP Berat. Nga regjistri, u evidentua gjithashtu se nuk ka patur mbipopullime në dhomat e sigurisë.

Dritaret e dhomave të sigurisë kishin përmasa të tilla që lejonin ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral. Ndërkohë, dhomat e sigurisë kishin edhe ndriçim artificial, që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Orari i veprimeve në dhomat e sigurisë që ndodheshin në IEVP Berat, ishte i miratuar nga drejtuesit e dy institucioneve, shefi i komisariatit të policisë Berat dhe drejtori i IEVP-së Berat, ndërsa në dhomën e sigurisë që ndodhej në spitalin e Beratit, veprimet kryeheshin me miratim të shefit të komisariatit.

Mbajtja në vëzhgim e dhomave të sigurisë, kryhej nga personeli i policisë të IEVP-së Berat dhe monitorohej nga sistemi i kamerave të këtij institucioni. Ndërsa në spitalin e Beratit, kryhej shërbim nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Berat dhe mbahej nën vëzhgim nga sistemi i kamerave të spitalit.

Sipas informacionit të mbledhur në institucion për ajrimin e këtyre personave përdorehin bokset e ajrimit të IEVP-së Berat.

Dhomat e sigurisë **nuk** ishin të kompletuara me të gjitha orenditë e nevojshme për jetesë si karrige, tavolinë, komodinë për mbajtjen e sendeve personale, si dhe mungonin një pjesë e dyshekëve dhe batanijeve.

Trajtimi me ushqim i personave që ndodheshin në dhomat e sigurisë të IEVP-së Berat, sigurohej nga kuzhina e këtij institucioni, tre herë në ditë sipas vakteve për të rriturit dhe 4 herë në ditë për të miturit. Ndërsa, në rastin e personave të arrestuar/ndaluar femra që ndodheshin në “dhomën e sigurisë” pranë spitalit rajonal, ushqimi sigurohej me katering nga Komisarati i Policisë Berat.

Takimi me avokatët mbrojtës dhe marrja në pyetje e personave të ndaluar/arrestuar që ndodhen në ambientet e IEVP Berat, nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurorët e çështjes, kryhet në ambientet e këtij institucioni, të destinuara për këtë qëllim. Në rastin e personave të ndaluar/arrestuar femra, marrja në pyetje kryhet në ambientet e punës të komisariatit të policisë.

Vizita mjekësore e personave të ndaluar/arrestuar kryhej brenda afatit 12 orë nga koha e pranimit në dhomat e sigurisë nga mjeku i cili ishte në organikë të DVP Berat. Dhoma e mjekut, e cila ndodhej në ambientet e kësaj drejtorie, ishte e pajisur me krevat, tavolinë, karrige dhe frigorifer për ruajtjen e ilaçeve të emergjencës. Në raft, mbaheshin kartelat mjekësore me dinamikën e vizitave mjekësore për çdo person të ndaluar/arrestuar, gjatë kohës të qëndrimit në dhomat e sigurisë.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm i ambienteve ku ndodheshin dhomat e sigurisë, kryhej nga rrjeti i ujësjellësit të qytetit Berat dhe **kishte mungesa**. U evidentua nga grupi i inspektimit, ishte mungesa e furnizimit me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Aktualisht, furnizimi me ujë i ambienteve të brendshme të institucionit kryhej me orar të reduktuar, tre herë në ditë nga 1orë e 30 minuta. Higjena personale dhe larja e trupit me ujë të ngrohtë, kryhej në ambientin e përbashkët që ndodhej në katin e parë të godinës në regjimin e brendshëm të IEVP-së Berat. Dhomat e sigurisë kishin gjenerator si burim rezervë për furnizimin me energji elektrike.

Gjatë ditëve të qëndrimit në dhomat e sigurisë, personave të ndaluar/arrestuar ju lejohej leximi i librave, si dhe ushtrimi i riteve fetare.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisarlatin e Policisë Berat, u evidentua se zbatoheshin kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar dhe procedurat standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019, ku për çdo njësi policie që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të pajisen me regjistrat për evidentimin e të dhënave të personave në cilësinë e të shoqëruarve apo të ndaluar/arrestuar në mjediset e policisë. Regjistrat ishin të mbajtur në rregull dhe të plotësuar sipas rubrikave.

“Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në Policinë e Shtetit”* dhe ishte i sekretuar. Personat e shoqëruar për në mjedisin e policisë të komisarlatit, sipas dispozitave ligjore, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësi i zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit¹⁰.

Në këtë komisarlat ndodhej edhe “Regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar”, ku regjistroheshin të dhënat e këtyre personave, sipas procedurave të kryera nga punonjësit e komisarlateve të policisë Berat, Kuçovë dhe Skrapar. Ky regjistër gjithashtu ishte i sekretuar dhe i plotësuar sipas rubrikave.

¹⁰ *Kreu VIII, Procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.*

Nga këqyrja e këtij regjistri, por dhe nga procesverbalet e personave të ndaluar/arrestuar që ndodheshin në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit, rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në mjedisin e policisë. Kjo praktikë ndiqej nga punonjësit e komisariateve të policisë në Berat, Skrapar dhe Kuçovë, të cilët në proces-verbalin e personave të ndaluar/arrestuar që shoqëroheshin për në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Berat, shënonin orën kur atyre ju privohej liria në momentin e shoqërimit në mjediset e komisariateve respektive. Dokumentimi i saktë i kohës në proces-verbalin e personave të ndaluar/arrestuar, që në momentin e privimit të lirisë në mjediset e policisë, përbën garanci për këta persona në llogaritjen e kohës gjatë qëndrimit në këto mjedise, pamvarësisht lëvizjeve nga Komisariami i Policisë Skrapar dhe Kuçovë, për në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Berat.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në këtë komisarimat, kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Për periudhën e inspektimit, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga këta persona.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarimatit të Policisë Berat, në mungesë të një ambienti më vete intervistimi, specialistët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet proceduriale me shtetasit e shoqëruar në zyrat e punës së tyre. Zyrat e punës nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave, ndryshe çfarë parashikohet në procedurën standarde për ambientet e intervistimit apo marrjes në pyetje të shtetasve.

Në dhomat e sigurisë që ndodheshin në IEVP Berat, kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës, e cila përdorej njëkohësisht dhe për takim me avokatët mbrojtës, e cila ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave.

Në lidhje me ambientet e intervistimit, Avokati i Popullit në zbatim edhe të rekomandimeve të CPT-së, ka rekomanduar në vijimësi marrjen e masave për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente. Nga inspektimet periodike që zhvillon MKPT-ja në drejtoritë dhe komisarimatet e policisë, konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar¹¹.

¹¹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Një problematikë e konstatuar nga grupi i inspektimi, kishte të bënte edhe me kohën e vënies në dispozicion të kartës me të drejtat ligjore personave të shoqëruar apo ndaluar në mjediset e policisë. Aktualisht, personat e shoqëruar/ndaluar nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se morën një kopje të fletës me të drejtat e tyre, në përfundim të procesit së marrjes në pyetje në organin e policisë. Por, CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse të policisë të shtetit gjatë inspektimit të kryer në vitin 2018-të, se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit), duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë¹². Sipas gjetjeve të inspektimit edhe të MKPT, karta me të drejtat e personave të ndaluar u jepej atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje dhe jo që në momentin e shoqërimit për në mjediset e komisariatit. Sa më sipër është një praktikë si rezultat i të cilës humbet qëllimin për të cilën jepet karta e të drejtave.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në Komisarlatin e Policisë Berat, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Në përfundim të procedurave, punonjësi i policisë e pajiste shtetasin e shoqëruar me një kopje të proces-verbalit, ku përcaktohej arsyeja e shoqërimit, ora e shoqërimit dhe pretendimet e shtetasit për ankesat në lidhje me trajtimin nga punonjësit e policisë, gjatë kohës së qëndrimit në mjedisin e policisë.

Personat e ndaluar/arrestuar, në bazë të kërkesave të përcaktuara në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje e proces-verbalit të ndalimit/arrestimit, proces-verbali i dorëzimit të sendeve personale, si dhe kopje e letrës me të drejtat që gëzojnë këta shtetas.

intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

¹² *Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 28¹².*

Nga inspektimi u evidentua gjithashtu se, personat e ndaluar/arrestuar në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, mund të kërkonin ndihmë për tu pajisur me avokatë mbrojtës, duke ju ofruar mundësinë e kontaktit me avokatët mbrojtës, nga lista e dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë. Në momentin e inspektimit nuk u mblodh informacion për cilësinë e shërbimit juridik pasi nuk kishte persona të arrestuar për të intervistuar.

Në ambientin e shoqërimit dhe atë të sigurisë të komisariatit, kishte të vendosur postera me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluarve/arrestuarve. Nga intervistimi i punonjësit të informacionit (në mungesë të personave të shoqëruar), kopja e letrës me të drejtat e të shoqëruarve, **nuk** ju jepej personave që në momentin e hyrjes në mjediset e komisariatit të policisë.

Dhënia e kartës me të drejtat e personave të privuar nga liria në mjediset e policisë së shtetit, si dhe afishimi i posterave në ambiente të aksesueshme nga të shoqëruarit, të arrestuarit dhe të ndaluarit, janë një garanci për informimin e këtyre personave për të drejtat e tyre, pavarësisht qëllimit të shoqërimit apo veprës penale të kryer prej tyre. Avokati i Popullit shpreh shqetësim të thellë për mungesën e këtyre elementëve minimal formal në lidhje me garantimin e të drejtave të personave të arrestuar.¹³

Në kuadër të të drejtës për informim, **punonjësi i policisë ka për detyrë ti njoh personat e shoqëruar me kartën e të drejtave që ju njih ligji**, e cila parashikon të drejtën për të kërkuar avokat mbrojtës (nëse e dëshiron), e drejta për të njoftuar familjarët e tij lidhur me faktin e shoqërimit dhe të vendndodhjes, si dhe për të kërkuar shërbim shëndetësor (nëse është e nevojshme prej tyre).

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryeshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, familjarëve (kujdestarit ligjorë) dhe të psikologut, i cili ishte në organikë të DVP Berat.

Grupi i ekspertëve konstatoi se vizitat mjekësore nga ana e personelit mjekësor kryeshin brenda afatit 12 orësh, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në dhomat e sigurisë, sikurse përcaktohet në procedurat standarde për “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Mjeku ishte në organikë të DVP Berat dhe kryente vizita mjekësore, sa herë paraqisnin kërkesa personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar. Në raste të urgjencave mjekësore, me rekomandimin e mjekut, këta persona shoqëroheshin për vizitë të specializuara te mjekët në Spitalin Rajonal të Beratit.

¹³ shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 10-11.

Vizitat mjekësore, konstatimet për shenja dalluese në paraqitjen e jashtme të personave që shoqërohen në mjediset e komisariatit, rekomandimet për vizita mjekësore dhe mjekimet e dhëna nga mjekët specialist, pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që administrohej nga mjeku i institucionit. Ndërkohë, për çdo person të ndaluar/arrestuar ishin hapur kartela ditore mjekësore, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës dhe shoqëronin këta persona kur dërgoheshin për vuajtjen e dënimit në IEVP.

Në përfundim të vizitës inspektuese nga sa u vu re në vend, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të shoqëruar/ndaluar/ arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, si dhe nenit 81, pika 2/b të ligjit 81/2020 ku përcaktohet se Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca: *“paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*:

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të projektit për *“Rikonstruksionin/Ndërtimin e objekteve të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat”*, pas miratimit të fondeve për zbatimin e këtij projekti, pasi vonesat kanë sjellë për pasojë përkeqësimin e gjëndjës së godinave duke vështirësuar garantimin e elementëve të sigurisë por edhe trajtimin dinjitoz për të ndaluarit/shoqëruarit apo edhe punonjësit e policisë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë brenda territorit të Komisarariatit të Policisë Berat, në përputhje me normat dhe parametrat teknikë të parashikuara në legjislacionin në fuqi, si dhe mbylljen e dhomave të sigurisë që ndodhen në ambientet e IEVP-së dhe Spitalin Rajonal Berat.
3. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një ambienti të ri shoqërimi, me dhoma të ndara më vete për qëndrimin e personave të rritur, femra dhe të mitur, me kushte dinjitoze dhe të pajisura me orenditë e nevojshme.

4. Të merren masa për mirëmbajtjen e dhomave ekzistuese të shoqërimit, për eliminimin e lagështirës në këto ambiente, deri në krijimin e një ambienti të ri shoqërimi.

5. Të merren masa për instalimin e sistemit të kamerave në ambientin e shoqërimit, me qëllim mbajtjen në vëzhgim të punonjësve të policisë gjatë veprimeve që kryejnë me të shoqëruarit.

6. Të merren masa të menjëhershme për krijimin e dhomës për intervistimin/marrjen në pyetje të të shoqëruarve në moshë madhore, para se të dërgohen në dhomat e sigurisë, me qëllim parandalimin e veprave të dhunshme ndaj shtetasve që mbahen dhe trajtohen në mjediset e policisë.

7. Marrjen e masave të menjëhershme për kompletimin me të gjitha orënditë e nevojshme për jetesë si dyshekë, batanije, karrige, tavolinë dhe komodinë për mbajtjen e sendeve personale të të ndaluarve/arrestuarve në dhomat e sigurisë.

8. Të merren masa të nevojshme nga institucioni që në bashkëpunim me Ujësjiellës Kanalizimet Berat, të përmirësojnë situatën e furnizimit pa ndërprerje me ujë të ambienteve të dhomave të sigurisë, me qëllim mbajtjen e higjënës personale të të ndaluarve/arrestuarve, si dhe pastërtinë në dhomat e banimit.

9. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në ambientet e komisariatit.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI